



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KESHILLI

Nr. 324/17 Prot.

Pogradec, më 02.02.2026

VENDIM

Nr. 09, datë 29.01.2026

**“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE ZNJ. XHEMILE SELKO, FAMILJE QË
KA PËSUAR DËME SI PASOJË E RENIES SE ZJARRIT NE BANESE”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 30 gërma “gj”, të Ligjit nr. 45, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile”, Kreut III, pika 1, shkronja “ë”, të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Të akordojë ndihmën financiare për znj. Xhemile Selko, shumë prej **375 607.37 Lekë** (treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatë) Lekë, familje që ka pësuar dëme në orëndi/pajisje elektroshtëpiake dhe të anes ndertimore si pasojë e renies së zjarrit në banesën e saj.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga komisioni përkatës pranë Bashkia Pogradec.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikës 1, të këtij vendimi, të përballohen nga Fondi i Emergjencave Civile, të parashikuar në Buxhetin e vitit 2026, të Bashkisë Pogradec.



4. Ndhimja financiare që do të akordohet, do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit znj. Xhemile Selko banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit
5. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve si dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkisë Pogradec, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLI
Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 24 vota

2. Vota Pro 24

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 29.01.2026